



PETRIT GASHI – Kryesues dhe Drejtor

Petrit Gashi ka lindur në Prishtinë, në vitin 1976. Edukimin bazik e ka përfunduar në Prishtinë, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës. Ndërsa, studimet post-diplomike i ka përfunduar në Britaninë e Madhe, respektivisht në Universitetin Staffordshire. Është i doktoruar në fushën e ekonomisë, dhe ka specializim tregtinë e jashtme. Në sferën e interesit të tij akademik hyjnë edhe procesi i tranzicionit, burimet natyrore, zhvillimi i sektorit privat, dhe industrializimi.

Që nga viti 2005, z. Gashi është mësimdhënës në Fakultetin Ekonomik, Universiteti I Prishtinës. Momentalisht mban shkallën akademike të Profesorit të Asociuar. Ligjeron lëndët e ekonomisë të tregtisë ndërkombëtare, biznesit ndërkombëtar, dhe të tranzicionit dhe zhvillimit. Punimet e tij janë të publikuara në disa revista shkencore. Z. Gashi ka publikuar në disa revista dhe publikime të tjera ndërkombëtare, si në *Small Business Economics*, *Global Trade and Customs Journal*, *Croatian Economic Survey*, dhe të tjera.

Z. Gashi është bursist i Fondacionit Fulbright.

Për shumë vite Z. Gashi ofron konsulence në politikëbërjen e vendit. Në bashkëpunim me Komisionin Europian, USAID, UNDP, Bankë Botërore, IFC, GIZ, z. Gashi ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në vend, krijimin e legjislacionit, analizën dhe draftimin e politikave ekonomike, menaxhimin e projekteve, dhe aktivitete të tjera (për më shumë shih CV në këtu).